



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.4

2004

6 Shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.114, datë 22.1.2004	Për zgjedhjen e komisionerëve të Avokatit të Popullit.....	99
Vendim i Kuvendit nr.115, datë 22.1.2004	Për shkarkimin e zotit Dhame Pite nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	99
Vendim i Kuvendit nr.116, datë 22.1.2004	Për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.68, datë 20.2.2003.....	100
Vendim i KM nr.52, datë 29.1.2004	Për procedurën e dhënies së lejes së përdorimit civil të lëndëve plasëse.....	100
Vendim i KM nr.53, datë 29.1.2004	Për procedurat dhe masën e trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension.....	102
Vendim i KM nr.54, datë 29.1.2004	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Bunavi, Vlorë.....	103
Vendim i KM nr.56, datë 29.1.2004	Për hapjen e vendkalimit të ri kufitar në Dobrunë, Has në kufirin shtetëror, tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën.....	104

Vendim i KM nr.57, datë 29.1.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve, të personave dhe të sasisë së nevojshme të karburantit për përdorim nga anijet e peshkimit”.....	105
Vendim i KM nr.58, datë 29.1.2004	Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.....	105
Udhëzim i MF nr.1, datë 30.1.2004	Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2004.....	106
Vendim i GJK nr.1, datë 30.1.2004	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.....	119
Vendim i GJK nr.2, datë 3.2.2004	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i pikave 3 e 5 të nenit 289 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.....	122
Vendim i KKRT nr.210, datë 30.1.2004	Për dhënie licence "Për televizionin vendor privat "abc".....	128
Vendim i KKRT nr.211, datë 30.1.2004	Për dhënie licence "Për televizionin vendor privat “Tv MAGIC CHANNEL”.....	129
Vendim i KKRT nr.212, datë 30.1.2004	Për dhënie licence "Për radio vendor privat “NACIONAL a.h.”.	129

VENDIM
Nr.114, datë 22.1.2004

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERËVE TË AVOKATIT TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen në detyrën e komisionerit të Avokatit të Popullit:

1. Zoti Gëzim Lleshi
2. Zoti Riza Poda
3. Zoti Jorgo Dhrami

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.115, datë 22.1.2004

PËR SHKARKIMIN E ZOTIT DHAME PITE NGA DETYRA E ANËTARIT TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 47 pika 2 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bërë me vendimin nr.116, datë 24.12.2003,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Dhame Pite shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.116, datë 22.1.2004

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË NR.68,
DATE 20.2.2003

Në mbështetje të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", neni 14 pika 4, ndryshuar me ligjin nr.8988, datë 24.12.2002, si dhe të neneve 28 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.68, datë 20.2.2003 "Për trajtimin e deputetëve" bëhen këto ndryshime:

I. Në pikën VI:

1. Fjalja e parë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

"Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në përdorim të deputetëve bëhet nga administrata e Kuvendit të Shqipërisë".

2. Paragrafi i dytë shfuqizohet.

II. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në vitin 2004, pas përfundimit të procedurave të prokurimit me objekt mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve të Kuvendit të Shqipërisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.52, datë 29.1.2004

PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË PËRDORIMIT CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Leja e përdorimit civil të lëndëve plasëse nga personat fizikë e juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, jepet nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.

2. Leja e përdorimit civil të lëndëve plasëse jepet për subjektet e licencuara nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, të hidrokarbureve dhe të ndërtimit, të cilat, për realizimin e veprimtarisë së tyre, kanë domosdoshmëri përdorimin e lëndëve plasëse.

3. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për përdorimin civil të lëndëve plasëse duhet të plotësojë këto kritere dhe kushte:

- Të jetë regjistruar në gjykatë si person juridik ose fizik;

- Të ketë vërtetim nga organi i pushtetit vendor të zonës ku do të përdoren lëndët plasëse, se në atë zonë ku do të ushtrohet veprimtaria me lëndë plasëse nuk ka objekte, që rrezikohen nga përdorimi i tyre;

- Të ketë lejen për ushtrimin e veprimtarisë, sipas pikës 2 të këtij vendimi;
 - Të ketë hartën topografike të zonës në shkallën 1:25000 dhe planimetrinë e zhvillimit të punimeve, me koordinatat e objektit ku do të përdoren lëndët plasëse;
 - Të ketë të përcaktuara llojin, sasinë dhe karakteristikat fiziko-kimike të lëndëve plasëse;
 - Të ketë llogaritjen e zonës së rrezikshme dhe pasaportën teknike të punës me lëndët plasëse;
 - Të sigurojë masat e sigurisë në punë, në përputhje me rregulloren e teknikës së sigurimit për punë me lëndët plasëse;
 - Të ketë miratimin për depon e lëndëve plasëse nga komisarati i policisë, që mbulon territorin ku kërkohet leja ose kontrata me një subjekt që zotëron depo të miratuar nga ky komisarati;
 - Të ketë kontratën e punës me drejtuesin teknik, inxhinier ose teknik miniere, inxhinier gjeolog, inxhinier ndërtimi, si dhe një fotokopje të noterizuar të diplomës;
 - Të ketë kontratën e punës me zjarrmëtarin dhe fotokopjen e noterizuar të dëshmisë së zjarrmëtarit;
 - Të ketë vërtetimin e regjistrimit të subjektit në RISHM (reparti i inspektim-shpëtim miniera);
 - Të ketë programin vjetor të kualifikimit të punonjësve, që merren me kryerjen e punimeve me lëndët plasëse.
4. Subjektet, për t'u pajisur me leje sipas këtij vendimi, duhet të paraqesin kërkesën me shkrim ku të shënohen:
- emri, mbiemri i kërkuesit dhe akti ligjor i përfaqësimit si person juridik ose fizik;
 - adresa e saktë e personit juridik ose fizik (tel/fax, celular);
 - veprimtaria që do të kryejë personi fizik ose juridik me lëndët plasëse.
5. Leja e përdorimit civil të lëndëve plasëse jepet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit me shkrim të kërkuesit. Kur nuk plotësohen të gjitha kërkesat e pikës 3 të këtij vendimi, kërkesa refuzohet me shkrim.
6. Afati i lejes për përdorim civil të lëndëve plasëse është i njëjtë me afatin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë në fushat e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe kur nuk ka sanksione për heqjen e lejes ripërtërihet së bashku me përtëritjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë.
7. Leja hiqet në rastet kur:
- subjekti, gjatë përdorimit civil të lëndëve plasëse, nuk plotëson rregullat teknike të përdorimit dhe rrezikon jetën e njerëzve, të kafshëve ose vlerave materiale;
 - subjekti kryen veprë penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së përdorimit të lëndëve plasëse.
8. Marrësi i lejes së përdorimit civil të lëndëve plasëse është i detyruar të kryejë punime brenda objektit për të cilin i jepet leja. Leja e dhënë nuk mund t'u transferohet personave të tjerë.
9. Personat e pajisur me leje të përdorimit civil të lëndëve plasëse janë të detyruar të zbatojnë rregullat dhe masat teknike, të miratuara në rregulloren përkatëse.
10. Kontrolli i përdorimit civil të lëndëve plasëse bëhet nga reparti i inspektim-shpëtim miniera (RISHM) dhe organet e specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj.
11. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.53, datë 29.1.2004

**PËR PROCEDURAT DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË
PILOTËVE FLUTURUES NË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes dhe të Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, në zbatim të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, të tërheqë nga dega e sigurimeve shoqërore dy formularë kërkesë për përfitim, të cilat t'i dorëzojë në repartin ku ka punuar deri në ndërprerjen e marrëdhënieve financiare apo në komandën e Forcave Ajrore, kur reparti është suprimuar dhe në degën e sigurimeve shoqërore, ku ka vendbanimin.

Dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e trajtimit të veçantë të përgatitet nga repartet ushtarake dhe të dërgohet në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila, pasi e shqyrton, e dërgon atë në degët përkatëse të sigurimeve shoqërore.

2. Për llogaritjet e trajtimit financiar të merret si bazë paga referuese, e cila përbëhet nga paga bazë për funksionin plus shpërblimin për gradë, të njësuar me pagën referuese të funksionit organik të ushtarakut aktiv, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes të së drejtës për këtë trajtim financiar.

- Paga bazë për funksion përfshin:

- a) pagën bazë për klasën e funksionit organik;
- b) shtesat për vjetërsi;
- c) shtesat për vështirësi vendi e shërbimi.

- Paga referuese për përfituesin, të cilit e drejta i lind nga data 1 janar 2004, përfshin:

- a) pagën bazë për gradë;
- b) shtesën për natyrë të veçantë;
- c) shtesën dëmshmëri shëndeti;
- ç) shtesën për ruajtje page.

3. Kur funksioni dhe grada e ushtarakut përfitues nuk ekzistojnë, Ministri i Mbrojtjes bën njësimin e tyre me funksionet dhe gradat aktuale.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzuesit dhe të dokumentacionit tip për zbatimin e këtij vendimi dhe për dhënien e pagave për shtesat mbi pension, sipas marrëveshjes me agjentin pagues.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të cilat llogariten për vitin 2003 në shumën 7 500 000 (shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe për vitin 2004 në shumën 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.54, datë 29.1.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I QENDRËS KOMBËTARE STËRVITORE BAZË (QKSB) TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BUNAVI, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Bunavi, Vlorë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listës emërore që i bashkëlidhet këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 12115 000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh, për sipërfaqen prej 24 230 m² tokë bujqësore.
4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 97 600 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë dhe është përballuar nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
6. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe të përfundojë brenda një muaji.
7. Pagesat të bëhen pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999.
8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU:VLORE

Listëpagesa e pronarëve që shpronësohen për shkak të ndërtimit të Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Bunavi, Vlorë.

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore Nr.1-7

Z. K	Pronari				Nr.pas.	Tokë bujqësore				Shënime sqaruese
	N r	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip.Shpr. m2	Çmimi Në lekë /m2	Vlera Në lekë	Vlera në lekë për t'u paguar	
1	1	Aleks	Pavlo	Dëma	106/8	1100	500	550000	550000	nr.pas.ndryshuar
3	2	Todi	Llambro	Kaçani	106/9	1750	500	875000	875000	
1	3	Vasil	Nasho	Tita	106/10	750	500	375000	375000	
6	4	Novruz	Sabri	Tahiri	106/18	3000	500	1500000	1500000	
B		Novruz	Sabri	Tahiri	113/15	3000	500	1500000	1500000	
U	5	Elez	Sabri	Tahiri	113/9	3680	500	1840000	1840000	
N	6	Abedin	Sabri	Tahiri	113/7	1500	500	750000	750000	
A		Abedin	Sabri	Tahiri	113/12	6450	500	3225000	3225000	
V	7	Ligor	Marko	Dëma	106/12	3000	500	1500000	1500000	pa certi.
I										
Shuma						24230		Shuma	12115000	

Shënim. Mbyllet me numrin rendor 7 (shtatë).

Shënim. Për të gjithë personat me shënimin pa certifikatë t'u mbahet e bllokuar pagesa deri në një njoftim të dytë nga ana jonë, deri sa të sjellin certifikatën për vërtetimin e pronësisë.

VENDIM
Nr.56, datë 29.1.2004

PËR HAPJEN E VENDKALIMIT TË RI KUFITAR NË DOBRUNË, HAS NË KUFIRIN SHTETËROR, TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME KOSOVËN

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 24 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 "Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e vendkalimit të ri kufitar në Dobrunë, Has në kufirin shtetëror, tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën për komunikacion kufitar.

2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.57, datë 29.1.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.495, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË PERSONAVE DHE TË SASISË
SË NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Shoqëria furnizuese e gazoilit për anijet e peshkimit të jetë "ARMO" sh.a., Fier. Çmimi i shitjes të jetë sipas përcaktimit të çmimit me shumicë, të publikuar nga kjo shoqëri."

2. Rimbursimi i akcizës të fillojë më datë 1 janar 2004.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.58, datë 29.1.2004

PËR ORGANIZIMIN E DREJTORISË SË SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) është person juridik, buxhetor në varësi të Kryeministrit.

2. Veprimtaria dhe detyrat e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përcaktohen në ligjin organik.

3. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar miratohen nga Kryeministri.

4. Për nëpunësit e kësaj Drejtorie zbatohet legjislacioni për shërbimin civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

5. Buxheti i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përbën zë të veçantë në buxhetin e Kryeministrit.

6. Pagat e nëpunësve të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përcaktohen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ndërsa punonjësit e tjerë paguhen sipas lidhjes II-5 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

7. Funksionimi i brendshëm bëhet sipas rregullores përkatëse të miratuar nga Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

Klasa	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Pagat e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
II-a	Drejtor	9000	2 %	0	90 000
III-b	Përgjegjës sektori	9000	2 %	0	40 000
IV-a	Specialist	9000	2 %	0	30 000
IV-b	Specialist	9000	2 %	0	20 000

UDHËZIM
Nr.1, datë 30.1.2004

PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2004

Në zbatim të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", Ministri i Financave

UDHËZON:

Zbatimin nga të gjitha institucionet buxhetore të rregullave të përcaktuara sipas kësaj përmbajtjeje:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Buxheti i Shtetit fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të këtij viti, i ndarë në katërmujorë.

Akordimet e planit të buxhetit për fondin e konsoliduar dhe për fondet speciale në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqësojnë limitin maksimal të lejuar për t'u zbatuar. Tejkalimi i limitit përbën shkelje të disiplinës financiare. Raportimi mujor i shpenzimeve faktike nga degët e thesarit bëhet sipas klasifikimit ekonomik, funksional dhe organizativ dhe sipas procedurave të thesarit. Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore është ai i përcaktuar me manualin e klasifikimit ekonomik buxhetor të miratuar nga Ministri i Financave.

Në mbështetje të nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", rialokimet e fondeve mes ministrive/institucioneve qendrore, si dhe nga një program në tjetrin për shpenzimet kapitale sipas tabelave 1 dhe 2 të ligjit bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave në masën deri në 7 (shtatë) për qind të totalit të fondeve të miratuara për çdo ministri/institucion. Rialokimet e tjera midis titujve, kapitujve dhe artikujve do të bëhen nga Ministria e Financave.

Nuk lejohet :

- rialokimi i fondeve nga shpenzimet korrente në kapitale dhe anasjelltas, pasi këta tregues janë miratuar në ligjin e buxhetit me tabela të veçanta;
- rialokimi i fondeve nga kapitujt që kanë si burim Buxhetin e Shtetit në ato që kanë si burim të ardhurat ose financimet e huaja dhe anasjelltas;
- rialokimi i fondeve nga shpenzimet për paga në shpenzimet operative, përveçse në rastet e parashikuara në pikën III.3 të këtij udhëzimi dhe kur Ministri i Financave vendos ndryshe.

I.1 Numri i punonjësve buxhetorë

Numri total i punonjësve të institucioneve buxhetore caktohet në ligjin e buxhetit të çdo viti. Numri i punonjësve për institucionet e pavarura nga Qeveria caktohet në ligjin e buxhetit, ndërsa për institucionet e tjera caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin për vitin 2004 të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore, çdo ministri/institucion qendror detajon numrin e punonjësve të linjës së varësisë së saj/tij dhe e depoziton atë pranë Drejtorisë së Buxhetit të Ministrisë së Financave jo më vonë se 10 ditë pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave për këtë qëllim. Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave, sipas detajimit të bërë nga çdo ministri/institucion qendror, dërgon pranë degëve të buxhetit numrin e punonjësve për çdo institucion buxhetor brenda muajit shkurt 2004 dhe këta të fundit e depozitojnë brenda 3 (tri) ditëve në degët e thesarit. Nga ky rregull përjashtohet depozitimi i numrit të punonjësve të SHISH-it, i cili paraqitet vetëm në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave. Për shkeljen e afateve dhe procedurave si më sipër, Ministri i Financave jep masa në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Në rastet e daljes së akteve ligjore/nënligjore, të cilat parashikojnë ndryshime në numrin e punonjësve të institucioneve buxhetore, ministrinë/institucionet qendrore të interesuara dërgojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit të Ministrisë së Financave, kërkesën për ndryshim të numrit të punonjësve dhe kjo e fundit dërgon ndryshimet pranë degëve të buxhetit, të cilat i depozitojnë brenda 3(tri) ditëve në degët e thesarit.

Në rastet e nevojave për rishpërndarje të numrit të punonjësve mes institucioneve të varësisë, ministrinë/institucionet qendrore të interesuara dërgojnë kërkesën e argumentuar pranë Drejtorisë së Buxhetit të Ministrisë së Financave. Këto kërkesa normalisht dërgohen vetëm një herë në çdo dy muaj në javën e fundit të tij, përveç rasteve emergjente. Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave pasi gjykon për domosdoshmërinë e rishpërndarjes së këtij numri, dërgon ndryshimet pranë degëve të buxhetit përkatëse dhe këto të fundit menjëherë nga marrja e tyre, në degët e thesarit.

Degët e thesarit, pasi verifikojnë numrin faktik të punonjësve për çdo institucion buxhetor, mbështetur në listëpagesat dhe në numrin e punonjësve të dërguar nga degët e buxhetit, raportojnë sistematikisht çdo muaj numrin (faktik) të punonjësve për të cilët është kryer shpenzimi. Numri i punonjësve që depozitohet dhe raportohet është i lidhur me personelin direkt buxhetor dhe me shpenzimet që kryhen në artikujt 600 dhe 601. Të gjitha institucionet buxhetore janë të detyruara që të paraqesin në degën e thesarit që i mbulon numrin faktik të punonjësve bashkë me dokumentacionin, i cili nevojitet për kalimin e shpenzimeve për pagat. Në rast të kundërt, dega e thesarit nuk lejon kryerjen e pagesës për pagat.

I.2 Të tjera

Degët e thesarit lejojnë kryerjen e pagesës për paga vetëm kur ajo shoqërohet me pagesën e plotë të kontributit për sigurime shoqërore e shëndetësore.

Për të gjitha llojet e shpenzimeve (korrente/kapitale) të fondit të konsoliduar dhe të fondeve speciale, në radhë të parë do të paguhet detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara. Ky rregull mbahet parasysh gjatë detajimit të planit të buxhetit nga ministrinë/institucionet qendrore.

Me prioritet ndiqen pagesat për shërbimet e furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Lidhur me shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH-it dhe ndërmarrjeve të ujësjellësve do të veprohet si më poshtë:

KESH dhe ndërmarrjet e ujësjellësit do të dërgojnë brenda datës 15 të çdo muaji në degën e thesarit listën e institucioneve të cilat nuk kanë shlyer detyrimet e muajit paraardhës. Lista duhet të jetë e azhurnuar çdo muaj. Pas marrjes së kësaj liste, degët e thesarit bëjnë bllokimin e shpenzimeve korrente (me përjashtim të pagave) për çdo institucion që merr fonde nga buxheti dhe i zhbllokun ato vetëm pas vërtetimit që faturat janë shlyer. Në rastin kur midis palëve ka kontradikta lidhur me detyrimin e pashlyer, dega e thesarit lejon kryerjen e pagesave vetëm në rast se paraqitet një vërtetim për fillimin e çështjes gjyqësore ndaj KESH-it apo ndërmarrjeve të ujësjellësve.

II. PROCEDURAT E DETAJIMIT TË PLANIT

II.1 Fondi i konsoliduar

Ministritë e linjës/institucionet qendrore bëjnë detajimin e buxhetit për institucionet nacionale të varësisë, në periudha dymujore, duke respektuar detyrimisht ndarjen katërmujore të miratuar nga Ministria e Financave. Këtë detajim ata e dërgojnë në degët e buxhetit, si dhe në institucionet buxhetore të varësisë së tyre. Një kopje të buxhetit, të detajuar si më sipër, ministritë e linjës/institucionet qendrore e depozitojnë në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave.

Ministritë e linjës, gjithashtu, bëjnë ndarjen e planit katërmujor për buxhetin e kushtëzuar të organeve të pushtetit vendor, në periudha dymujore, sipas destinacioneve dhe institucioneve në nivel vendor dhe e depozitojnë atë në degët e buxhetit.

Për buxhetin që Ministria e Mbrojtjes detajon në strukturat përkatëse të varësisë së saj, si urdhëruese të shkallës së dytë, degët e buxhetit bëjnë regjistrimin e tij në rrethin përkatës. Pas kësaj, strukturat që varen nga Ministria e Mbrojtjes i paraqesin degës së buxhetit që i mbulon shkresat për detajimin e mëtejshëm sipas reparteve të vartësisë së tyre për të gjithë shumën e akorduar. Dega e buxhetit, pasi verifikon rakordimin e këtyre detajimeve me shumën e akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, firmos shkresat e transferimeve (detajimeve) për rrethet e tjera.

Ministritë dhe institucionet qendrore janë të detyruara të çelin në degët e buxhetit të gjitha fondet buxhetore.

- Meqenëse fondet e ndihmës ekonomike dhe të përfitimit të paaftësisë detajohen dhe çelen nga Shërbimi Social Shtetëror, depozitimi i tyre në fillim të vitit bëhet në Degën e Buxhetit Tiranë, të ndara në dymujore, duke respektuar nivelet katërmujore të detajimit nga Drejtoria e Buxhetit në Ministrinë e Financave. Transferimi i këtyre fondeve në organet e pushtetit vendor bëhet nga Shërbimi Social Shtetëror, pasi merr miratimin e Drejtorisë Ekonomike të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe pas konfirmimit nga Drejtoria e Buxhetit e Ministrisë së Financave, brenda datës 5 të muajit të parë të dymujorit.

- Fondet e nxitjes së punësimit që administrohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) detajohen në degët e buxhetit, të ndara në dymujore. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për projektet fituese, njofton degën e buxhetit përkatëse, e cila bën çeljen në degën e thesarit. Lejohet avancimi i fondeve të sipërpërmendura nga katërmujori në katërmujor, kur kjo shihet e nevojshme nga SHKP dhe pasi është marrë konfirmimi nga Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe fondi i kontingjencës depozitohen në degën e buxhetit Tiranë dhe, pasi rakordohet me Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave, raportohet prej tyre në këtë drejtori çdo muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës.

II.1.1 Detajimi dhe çelja e fondeve për investime

Plani i investimeve, i miratuar me ligjin nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, tabela 2, i ndarë në katërmujorë, detajohet me objekte sipas strukturës buxhetore dhe i dërgohet për miratim Ministrisë së Financave nga ministritë/institucionet qendrore. Një kopje e planit të detajuar i dërgohet për njoftim Ministrisë së Ekonomisë.

Plani i detajuar dërgohet për zbatim në degët e buxhetit në nivel vjetor dhe i ndarë në katërmujorë, për çdo objekt investimi. Për rastet e përshpejtimit të procedurave të prokurimit apo të punimeve, lejohet avancimi i fondeve të investimeve nga katërmujorët pasardhës, pasi të paraqiten me shkrim nga ministritë e linjës/institucionet qendrore në degët e buxhetit, kërkesa me argumentimin se përse kërkohet avancimi i fondit të investimit.

Ministritë e linjës, institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe organet e pushtetit gjyqësor, në detajimin e fondeve të investimeve për vitin 2004, detyrimisht, do të ndjekin këtë radhë prioritare: së pari, do të mbulojnë punimet e kryera, por të pafinancuara gjatë vitit 2003, së dyti, objektet e kontraktuara apo në vazhdim nga vitit i kaluar dhe së fundi, investimet e reja.

Degët e buxhetit, pasi marrin planin e investimeve nga Drejtoria e Buxhetit dhe konfirmimin me shkrim për kryerjen e procedurës së prokurimit bashkë me kontratën e lidhur midis palëve, nga ministritë ose institucionet e tjera në varësi të vlerës së përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me rregullat e prokurimit publik, autorizojnë, brenda 3(tri) ditëve, çeljen e fondeve për investime pranë degëve të thesarit për vlerën e prokurimit, por gjithsesi jo më shumë se

vlera e planifikuar e fondit të investimit. Konfirmimi duhet të jetë i firmosur nga urdhëruesi i fondeve të ministrisë/institucionit buxhetor.

Për investimet e sistemit të Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, që kanë të bëjnë me konservim, mbyllje e projekte studimore, do të veprohet sipas udhëzimit të veçantë të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës. Për investimet e tjera të kësaj ministrie, zbatohen kriteret që përmban ky udhëzim, si për të gjitha ministritë e linjës. Për raste specifike veprohet në bazë të udhëzimeve të veçanta midis Ministrisë së Financave dhe ministrive të linjës.

Investimet nga të ardhurat e veta. Për investimet që përballohen nga të ardhurat e veta të institucionit buxhetor, ministritë e linjës/institucionet qendrore nga të cilat ata varen autorizojnë çeljen me objekte dhe përdorimin e tyre sipas kriterëve të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore që lidhen me rregullat e prokurimit publik. Të ardhurat e pushtetit vendor për investime ndjekin rregulla specifike të përcaktuara më poshtë.

Procedura. Institucionet buxhetore, pasi marrin fondin e planifikuar për objektin e investimit, kur janë vetë palë investitore, zbatojnë procedurat e prokurimit, lidhin kontratën me palën sipërmarrëse dhe mbajnë përgjegjësi për hartimin e kësaj kontrate, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një kopje e kontratës depozitohet me shkresë përcjellëse në degën e buxhetit përkatës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja palët (investitori e sipërmarrësi).

Afati. Për të siguruar një ritmikë optimale në realizimin e investimeve dhe efikasitet më të lartë në përdorimin e fondeve buxhetore, investimet që figurojnë të paprokuruar deri më datë 1 nëntor 2004 bllokohen. Në kuptim të këtij udhëzimi, objekte investimi të paprokuruar do të quhen ato për të cilat në datën 1.11.2004 nuk është lidhur ende kontrata me sipërmarrësit dhe investitorit. Në këtë procedurë mbahen parasysh edhe afatet ose kriteret që vendosen nga Këshilli i Ministrave.

Ngurtësimi dhe paradhënia. Ndalohej përdorimi i formës së ngurtësimit në llogari të klientit për të gjitha kontratat (investime, shërbime). Në lidhjen e kontratave për investimet që kanë të bëjnë me ndërtimet e reja apo rikonstruksione, nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies përveçse për raste të veçanta deri në 10 (dhjetë) për qind të vlerës së kontratës.

Raportimi. Degët e buxhetit janë të detyruara që, në fund të çdo dymujori (data 10 e muajit pasardhës), të dërgojnë në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave informacionin i cili përmban: listën e plotë të objekteve për periudhën përkatëse, nga këto: objektet e prokuruar dhe diferencën mes vlerës së planifikuar e asaj të prokuruar për objektet e prokuruar.

II.1.2 Detajimi dhe çelja e fondeve për investimet me financim të huaj

Me qëllim që të sigurohet një përputhje sa e më e plotë midis programit të investimeve me financim të huaj dhe raportimit faktik të tyre, të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore që kanë financime të huaja detajojnë, së bashku me investimet e brendshme në objekte edhe ato të huaja dhe i dërgojnë në Ministrinë e Financave për miratim. Ministria e Financave, pasi shqyrton përputhshmërinë me treguesit e ligjit të buxhetit të vitit 2004 dhe politikat e miratuara në Kuvend, miraton këtë detajim dhe e dërgon në degët e buxhetit, të cilat e depozitojnë brenda tri ditëve në thesar.

Për projektet me financim të huaj mund të zbatohen procedura të ndryshme raportimi në varësi të specifikimeve të bëra nga Drejtoria e Thesarit dhe e Borxhit në Ministrinë e Financave (procedura të pjesshme thesari/ procedura të plota thesari). Për projektet me financim të huaj, për të cilat nuk raportohet nëpërmjet thesarit, ministritë/institucionet qendrore janë të detyruara të dërgojnë raportet e tyre çdo muaj në Drejtorinë e Thesarit dhe të Borxhit të Ministrisë së Financave. Mbi këtë bazë, për çdo projekt me financim të huaj, pjesë e ligjit të buxhetit të vitit 2004, duhet të ketë raportim, qoftë direkt nga degët e thesarit, ashtu edhe indirekt nga ministritë e linjës/institucionet qendrore.

II.2 Fondet speciale

Në fondet speciale përfshihen sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe fondet e kushtëzuara (financimet e huaja dhe të ardhurat që krijojnë institucionet gjatë aktivitetit të tyre).

Detajimi i pjesës së fondeve për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor kryhet nga vetë këta të fundit, brenda ndarjes katërmujore që miratohet nga Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave.

Detajimi i limitit të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta, për çdo institucion buxhetor, bëhet në të njëjtën mënyrë si për shpenzimet e tjera buxhetore. Ky detajim dërgohet nga ministritë e linjës/institucionet qendrore në degët e buxhetit dhe një kopje dërgohet për njoftim në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave. Edhe procedurat e transferimit për limitin e përdorimit të të ardhurave janë të njëjta me ato të shpenzimeve të tjera buxhetore. Ministritë/institucionet qendrore lejohen të transferojnë edhe të ardhura të krijuara nga një institucion buxhetor i varësisë në një tjetër, gjithnjë shoqëruar me konfirmimin e degës së buxhetit ku bëhet pakësimi. E njëjta procedurë zbatohet edhe nga Ministria e Mbrojtjes për strukturat e saj vartëse, si dhe nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke ruajtur kriteret e përdorimit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Degët e thesarit nuk lejojnë kryerjen e shpenzimeve mbi limitin e përdorimit të të ardhurave edhe pse niveli i mbledhjes së tyre nuk kufizohet gjatë vitit buxhetor. Çelja e fondeve për përdorimin e të ardhurave bëhet në përputhje me sasinë e mbledhur të tyre. Përdorimi i tyre rregullohet me udhëzime të përbashkëta të Ministrisë së Financave me ministritë e linjës/institucionet qendrore.

Të ardhurat jashtë limitit evidentohen me strukturë të veçantë buxhetore (kapitulli 6) Në të ardhurat jashtë limitit përfshihen:

- Të ardhurat që mbliidhen nga zyrat e përmbarimit për llogari të të tretëve.
- Paradhëniet për pjesëmarrje në ankand dhe garancitë bankare (kur janë të kthyeshme).
- Sponsorizime me destinacion të përcaktuar nga donatori.
- Të ardhurat nga fondi që realizohet nga Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë prej 1(një)për qind mbi fondin e pagave të ndërmarrjeve dhe institucioneve jobuxhetore.
- Derdhjet e gabuara që duhen rikthyer kur vërtetohen si të tilla.
- Të ardhurat që mbledh Policia Elektrike për llogari të KESH-it.
- Të ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga llotosporti ose nga sponsorizimet e tjera.
- Të ardhurat nga agjentë tatimorë për institucionet jobuxhetore.
- Të ardhurat nga kasat e regjistrimit.

Të ardhurat e përcaktuara më sipër barten në vitin buxhetor pasardhës. Mbi bazën e rakordimit që institucioni bën me degën e thesarit e cila e mbulon, dega e buxhetit përkatëse jep autorizimin e shpenzimit për këto të ardhura.

Të ardhura jashtë limitit që nuk barten në vitin buxhetor pasardhës, janë:

- Të ardhurat nga vendosja e sanksioneve dhe shitjes së mallrave të konfiskuara të zbatimit të ligjit nr. 8449 datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".
- Të ardhurat nga ankandet për mallrat kontrabandë.
- Të ardhurat nga shitja e pullës fiskale të akcizës për pijet alkoolike dhe duhan-cigareve.
- Të ardhurat nga agjentë tatimorë që janë institucione buxhetore.

Fondet përkatëse nga financimi i huaj si për rastin kur funksionojnë sipas skemës së plotë të thesarit, ashtu edhe kur funksionojnë sipas skemës së pjesshme, kur nuk përdoren brenda vitit buxhetor, barten në vitin pasardhës dhe nuk u nënshtrohen kufizimeve të tjera që zbatohen për fondet buxhetore sipas këtij udhëzimi.

Për financimet e huaja që zbatojnë skemën e plotë të thesarit, degët e buxhetit pasi marrin kërkesën për çelje nga njësia e menaxhimit/zbatimit të projektit bashkë me një kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Thesarit dhe e Borxhit e Ministrisë së Financave, bëjnë çeljen e fondit në degën e thesarit, sipas strukturës buxhetore të përshkruar në autorizimin e lëshuar. Për fondet e papërdorura nga viti i kaluar buxhetor, degët e buxhetit, pasi marrin konfirmimin nga dega përkatëse e thesarit dhe njësia e zbatimit të projektit, shoqëruar me një kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Thesarit dhe e Borxhit, bëjnë çeljen e fondit.

III. PROCEDURAT E ZBATIMIT TË BUXHETIT

1. Transferimet e fondeve buxhetore lejohen, si rregull, vetëm një herë në çdo dy muaj, në fund të periudhës. Për transferime jashtë këtyre afateve vendos Ministria e Financave, mbi bazën e argumentimit që bën ministria/institucioni qendror. Numri i transferimeve për çdo institucion qendror është pjesë e treguesve për vlerësimin e zbatimit të buxhetit për institucionin. Transferimet, si nevojë për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, kryhen në përputhje me procedurat për transferimin e fondeve, por ato nuk i nënshtrohen kufizimeve kohore të mësipërme.

Transferimet e fondeve buxhetore korrente nga një titull, kapitull dhe artikull në një tjetër brenda të njëjtit grup miratohen nga Ministria e Financave. Për shpenzimet kapitale mbahen parasysh kufizimet e përcaktuara në pikën I. Çdo propozim për transferim fondesh duhet të vijë nga ministritë/institucionet qendrore, mbi bazën e kërkesave të argumentuara të institucioneve buxhetore të varësisë së tyre.

Kërkesa për transferim fondesh shoqërohet, detyrimisht, me një kopje të konfirmimit të degës së buxhetit ku do të bëhet pakësimi i fondit. Degët e buxhetit janë të detyruara t'u përgjigjen për çdo rast kërkesave të ministrive/institucioneve qendrore për të konfirmuar pakësimin. Konfirmimi i gjendjes që do të pakësohet shoqërohet me bllokimin nga degët e thesarit të fondit përkatës që do të pakësohet.

Transferimet midis institucioneve nacionale brenda të njëjtit grup, titull, kapitull dhe artikull kryhen nga vetë ministritë/institucionet qendrore dhe ekzekutohen vetëm pasi të jenë konfirmuar nga Ministria e Financave. Kështu veprohet edhe për institucionet vendore për pjesën e fondeve nga transferta e kushtëzuar.

Detajimet që kanë natyrë transferimi nga buxheti nacional në atë lokal, me përjashtim të fondeve të ndihmës ekonomike dhe përfitimit të paaftësisë, bëhen nga ministritë/institucionet qendrore, pasi merret konfirmimi nga Drejtoria e Buxhetit e Ministrisë së Financave.

Degët e buxhetit kanë të drejtë të kryejnë transferime fondesh për funksione të deleguara nga një organ i pushtetit vendor në tjetrin brenda territorit të tyre, brenda të njëjtit grup, titull, kapitull dhe artikull, me marrëveshje midis palëve, duke njoftuar njëkohësisht ministrinë e linjës përkatëse dhe Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave, çdo katërmujor.

2. Fondet e kushtëzuara të krijuara nga të ardhurat e institucioneve dhe të papërdorura në fund të vitit nuk barten në vitin e ardhshëm buxhetor, me përjashtim të të ardhurave të pushtetit vendor dhe të ardhurave jashtë limitit të përcaktuara në pikën 2.1 të këtij udhëzimi.

3. Për fondin e veçantë, i cili është pjesë e artikullit 600, në rastet kur nevojitet, vetë institucionet buxhetore kanë të drejtë të kryejnë transferime nga artikulli 600 në artikujt 602 dhe 604, sipas natyrës së shpenzimit për raste shpërblimesh apo aktivitete të tjera (ekskursione, fatkeqësi etj.). Dega e buxhetit përkatëse i paraqet këto transferime në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave në fund të çdo katërmujori, së bashku me shkresat e tjera të transferimeve të kompetencës së saj. Institucionet buxhetore, njëkohësisht, njoftojnë për këto transferime ministritë/institucionet qendrore nga të cilat varen.

Përllogaritja e fondit të veçantë dhe përdorimi i tij nuk mund të jenë më tepër se pesë për qind e fondit të planifikuar të pagave.

4. Analiza e zbatimit të buxhetit. Institucionet buxhetore janë të detyruara që të paraqesin, një herë në muaj në ministrinë/institucionin qendror nga i cili varen, situacionin e shpenzimeve dhe të dhëna të tjera plotësuese për buxhetin, si: numrin faktik të punonjësve, të ardhurat buxhetore jotatimore të realizuara dhe të përdorura, subvencionet etj. Ndërsa ministritë e linjës/institucionet qendrore paraqesin në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave situacionin faktik të plotë të dymujorit dhe në mënyrë progresive sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional së bashku me analizën buxhetore të kësaj periudhe, brenda datës 20 të muajit pasardhës.

5. Për të gjitha llojet e subvencioneve, zbatohen udhëzimet që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e tyre, të cilat ndryshojnë kur lind nevoja e përsosjes së procedurave, rregullave apo afateve. Dhënia e subvencionit bëhet sipas afateve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse, por duke respektuar detajimin e subvencionit në periudha katërmujore dhe dymujore. Kalimi i shumës së subvencionit në llogarinë bankare të përfituesit kryhet me urdhër të institucionit dhënës, duke

zbatuar procedurat përkatëse. Dhënia e kështit të parë bëhet sipas planit në formë paradhënie, ndërsa në rastet e tjera dhënia e subvencionit bëhet sipas situacionit, jo më shumë se plani, duke zbritur diferencën e situacionit të periudhës së mëparshme. Në asnjë rast, subvencioni nuk jepet më tepër nga plani. Kur situacioni i periudhës së mëparshme paraqitet me tejkalim, ai nuk merret parasysh. Institucioni dhënës i subvencionit (ministria e linjës, institucioni buxhetor, organi i qeverisjes vendore), përveç situacionit, kërkon edhe një kopje të dokumenteve justifikuese bashkëlidhur me të. Institucioni dhënës i subvencionit ka detyrim të ushtrojë kontroll dhe të kërkojë ekspertim për situacionet dhe dokumentacionin përkatës. Në fund të vitit buxhetor, por gjithsesi jo më vonë se muaji shkurt i vitit pasardhës, në degën e thesarit paraqitet një kopje të relacionit të kontrollit. Për rastet kur kontrolli nuk ka përfunduar bëhet njoftimi provizor. Në rast të kundërt, dega e thesarit bën pezullimin e dhënies së fondeve të reja për subvencionin.

6. Kërkesat për përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave

Sipas nenit 21 të ligjit organik të buxhetit nr.8379, datë 29.7.1998, Fondi rezervë përdoret "... për të përballuar shpenzimet e paparashikuara në Buxhetin e Shtetit..." dhe më tej: "Fondi rezervë përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimeve të ministrive dhe institucioneve të linjës dhe pas miratimit të dhënë nga Ministri i Financave".

Në zbatim të këtij neni, kërkesa e ministrive të linjës për përdorimin e këtij fondi kalon në këto faza:

i) Ministrinë e linjës paraqesin në Ministrinë e Financave një projekt, me të cilin argumentojnë: nevojat për shtesë fondesh, përse nuk është përfshirë në buxhetin e vitit ushtrimor, pamundësinë për t'u përballuar nëpërmjet rialokimit të fondeve, duke u nisur nga analiza e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese etj. Kur kërkesa ka të bëjë me investimet (ndërtim-montime e rikonstruksione), bashkë me projektin paraqitet edhe preventivi për t'u njohur me vlerën rreth së cilës parashikohet të kryhet prokurimi.

ii) Ministria e Financave, pas analizës së saj, jep vërejtjet, sugjerimet të cilat duhet të sqarohen dhe plotësohen detyrimisht kur të përgatitet projektvendimi përfundimtar.

iii) Me mendimin e ministrive të interesuara, bashkëlidhur dhe aprovimin e Ministrisë së Financave, projektvendimi paraqitet në Këshillin e Ministrave.

Në të gjitha rastet kur projektaktet e propozuara kanë efekte financiare, ministrinë dhe institucionet propozuese plotësojnë një aneks standard që përgatitet nga Ministria e Financave.

7. Plani në valutë. Drejtoria e Thesarit dhe e Borxhit shqyrton kërkesat e ministrive të linjës/institucioneve qendrore për valutë, propozon kuotën për vitin planifikues të ndarë sipas zërave dhe ia paraqet Drejtorisë së Buxhetit për ta përfshirë në buxhetin e ministrive të linjës. Pas miratimit të buxhetit, Drejtoria e Thesarit dhe e Borxhit dërgon në Degën e Thesarit Tiranë limitet e miratuara për konvertim në valutë për çdo katërmujor, të detajuara sipas institucioneve dhe zërave në përputhje me fondet buxhetore në lekë, të miratuara në buxhetin e ministrive të linjës/institucioneve qendrore.

8. Blerja e autovekurave për të gjitha institucionet buxhetore do të lejohet vetëm pas lëshimit të autorizimit për këtë qëllim nga Ministri i Financave, pasi të jenë plotësuar këto kushte:

- Paraqitja e një relacioni të argumentuar për gjendjen ekzistuese të automjeteve (numri, gjendja fizike, viti i blerjes, fondi i shpenzuar).

- Numri i personelit të institucionit që kërkon autovekurën (gjithsej/pa personelin mbështetës)

- Shpenzimet operative të lidhura me përdorimin e autovekurave (paga shoferësh dhe dieta, karburant, pjesë ndërrimi, servise etj.)

- Në asnjë rast nuk do të jepet autorizim për zëvendësimin e autovekurave pa kaluar të paktën 5 vjet nga blerja e autovekurës ekzistuese.

Këto rregulla mund të kërkojnë nga këshillat përkatëse kur miratohen fonde për blerje autovekurash për organet e pushtetit vendor. Në të gjitha rastet, për automjetet teknologjike të transportit nuk do të zbatohet ky rregull.

IV. BUXHETET E PAVARURA

IV.1 Buxheti i pushtetit vendor

Me miratimin e Buxhetit të Shtetit nga Kuvendi, çdo njësi e qeverisjes vendore përgatit buxhetin për ta miratuar në Këshillin e Qeverisjes Vendore, të cilin, pas miratimit nga ky këshill, e depoziton në degën e buxhetit. Deri në miratimin nga Këshilli, njësitë vendore duhet të vazhdojnë të përdorin çdo muaj të ardhurat dhe shpenzimet në masën sa 1/12 e nivelit të këtyre treguesve, të miratuar në vitin e mëparshëm buxhetor.

Në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore do të pasqyrohen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, pavarësisht nga natyra e tyre dhe burimet e financimit. Ky buxhet duhet të paraqitet i balancuar (pa deficit).

Të ardhurat do të përfshijnë:

1. Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël dhe nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.
2. Të ardhurat e parashikuara sipas sistemit të taksave vendore, të përcaktuara me ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore".
3. Të ardhurat jotatimore ku futen: të ardhurat nga shërbimet e ndryshme, të ardhurat nga shitja dhe dhënia me qira e trojeve, nga kontributet, sponsorizimet, gjobat etj.
4. Të ardhurat e krijuara nga institucionet që janë në varësi të qeverisjes vendore, të cilat përdoren nga vetë institucioni ku krijohen.

5. Transferta e pakushtëzuar nga pushteti qendror.

6. Transferta e kushtëzuar nga pushteti qendror.

Shpenzimet do të përfshijnë:

1. Shpenzimet për funksionet e veta (ekskluzive).

2. Shpenzimet për funksionet e deleguara.

3. Shpenzimet për funksionet e përbashkëta.

Shpenzimet për funksionet e veta janë:

1. Të gjitha shpenzimet për administratën vendore, duke përfshirë pagat, kontributin e sigurimeve shoqërore, shpenzimet operative dhe ato për investime.

2. Të gjitha shpenzimet për shërbimet publike, si: pastrim, gjelbërim, dekor, funeral, ndriçim qyteti etj., duke përfshirë kosto të personelit, shpenzime operative dhe investime.

3. Të gjitha shpenzimet për institucionet vendore të kulturës dhe sportit (me përjashtim të shpenzimeve për cilësinë sportive).

4. Të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve lokale.

5. Shpenzimet për transportin urban.

6. Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.549, datë 7.11.2002 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 "Për përfitime nga statusi i të verbërit", këshillat e qarqeve bëjnë financimin e degëve të Shoqatës së të Verbërve.

Shpenzimet për funksionet e përbashkëta janë:

1. Arsimi: Shpenzimet e pagave, kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore, investimet, si dhe shpenzimet për transportin e nxënësve dhe të mësuesve do të financohen me fonde të kushtëzuara nga Ministria e Arsimit, ndërsa shpenzimet operative për funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollë do të financohen nga pjesa e buxhetit të pavarur të njërive të qeverisjes vendore.

2. Shëndetësia: Duke filluar nga vitit 2004, shpenzimet për funksionimin e shërbimit shëndetësor parësor do të financohen totalisht me fonde të kushtëzuara nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Të tjera: Edhe për vitin 2004 funksionet e furnizimit me ujë të pijshëm, të kanalizimeve dhe të rrugëve urbane do të mbulohen me fonde të deleguara.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të përdorin fondet e pakushtëzuara për të financuar edhe funksione që financohen me fonde të kushtëzuara.

Transferta e pakushtëzuar që nuk përdoret plotësisht gjatë vitit buxhetor mbartet për vitin e ardhshëm.

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli do të bazohet te numri i punonjësve që vendoset nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe nga nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi

pagë, sipas akteve nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Çdo rritje, brenda kufirit maksimal të miratuar, duhet të bëhet me kushtin që: 1) të ruhet niveli i shpenzimeve të vitit të mëparshëm për shërbimet publike dhe 2) të rritet niveli i të ardhurave vendore në raport me vitin e kaluar.

Njësitë e qeverisjes vendore zbatojnë edhe detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore për të cilat ato janë ngarkuar ose ngarkohen nga këto vendime, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.335, datë 2.6.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit".

Fondi rezervë. Bazuar në nenin 6 të ligjit nr.8399, datë 9.9.1998 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7776, datë 22.12.1993 "Për buxhetin vendor", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, krijohet fondi rezervë në masën jo më shumë se 3(tre)për qind e totalit të shpenzimeve të miratuara.

Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Financave detajojnë fondin e kompensimit sipas kritereve të përcaktuara në aneksin 2 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 si më poshtë:

A. Fonde vetëm për bashkitë dhe komunat

1. Kompensimi vetëm për ripërshtatjen e kapacitetit fiskal.
 2. Mbështetje në absorbimin dhe implementimin e reformës së decentralizimit.
 3. Kompensimi bazuar në kriteret e varfërisë.
 4. Dhënie hua për tremujorin e parë 2004 pa interes njërive të qeverisjes vendore që kanë mospërputhje ndërmjet nevojave për shpenzime dhe arkëtimit të taksave të tyre.
- Kthimi i huasë do të bëhet brenda 15 prillit 2004.

B. Fonde vetëm për qarqe

1. Disa shpenzime operative që mund të lindin gjatë vitit.

Procedura për dhënien e huasë. Çdo njësi e qeverisjes vendore, në bazë të kritereve të vendosura në aneksin 2 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2004", ka të drejtë të kërkojë hua pa interes për mospërputhjen midis nevojave për shpenzime dhe arkëtimit të taksave të tyre, për të cilën:

1. Njësia e qeverisjes vendore do të paraqesë një kërkesë pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, brenda tremujorit të parë të vitit 2004. Kjo ministri, pasi e konsideron të argumentuar, ia paraqet për miratim Ministrisë së Financave.

2. Si burim për akordimin e huasë shërben fondi i kompensimit, pjesë e transfertës së pakushtëzuar.

3. Kjo hua duhet të kthehet në Buxhetin e Shtetit brenda datës 15 prill. Për çdo tejkalim të afatit do të aplikohen sanksione.

4. Huaja që do të kthehet nga njësitë e qeverisjes vendore, si pjesë e të ardhurave të tyre, do të regjistrohët në strukturën buxhetore Gr.74 Tit.141 Kap.6

5. Granti kompensues që do t'u akordohet njërive të qeverisjes vendore nga ky fond do të detajohet nga njësitë vendore, sipas strukturave të përcaktuara, por në kapitullin 6.

IV.1.1 Transferta e kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar në buxhetin e vitit 2004 është dhënë për financimin e një pjese të shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Këto fonde do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin ato janë miratuar. Kjo do të thotë që këto janë fonde të ministrive/institucioneve qendrore dhe për transferimin e tyre nga një njësi e qeverisjes vendore në një tjetër do të veprohet sipas pikës III.2 dhe III.3 të këtij udhëzimi. Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund t'i përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ligjin për Buxhetin e Shtetit. Shumat prej këtyre transfertave, të mbetura të papërdorura në fund të vitit buxhetor, nuk barten në vitin pasardhës.

Për zbatimin e projektit për pilotimin e investimeve të arsimit në Bashkinë e Tiranës do të ndiqet kjo procedurë:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në konsultim me Bashkinë e Tiranës, brenda fondeve të investimeve të miratuara me ligjin e buxhetit të vitit 2004, përcakton shumën e investimeve që do të përdoren në Bashkinë e Tiranës.

- Në shumën që përcaktohet për Bashkinë e Tiranës përfshihen vetëm investime për projekte të reja (ndërtime të reja dhe rikonstruksione). Kjo shumë përfshin edhe vlerën e shpronësimeve (nëse kjo është e nevojshme), vlerën e studimit, si dhe pajisjet.

- Të gjitha objektet në vazhdim, me financim të brendshëm ose të huaj, do të vazhdojnë të kryhen nga palët që kanë nënshkruar kontratat përkatëse, pra drejtoritë arsimore dhe njësitë e zbatimit të projekteve të huaja.

- Bashkia e Tiranës, në përputhje me prioritetet e saj, përcakton listën me objekte dhe e paraqet në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Kjo ministri pas shqyrtimit e paraqet në Ministrinë e Financave, e cila pas miratimit e depoziton në degët e buxhetit.

IV.1.2 Procedurat e zbatimit të buxhetit vendor 2004

Buxheti, së bashku me anekset përkatëse dhe me vendimin e këshillit, duhet të dërgohet në prefekturën e qarkut.

Pas konfirmimit të vendimit të këshillit për buxhetin nga prefekti i qarkut, pasqyrat e buxhetit të detajuara në 4-mujorë dhe 2-mujorë dërgohen në degën e buxhetit, e cila i dërgon për zbatim në degën e thesarit. Buxheti i organeve të pushtetit vendor dërgohet i ndarë për shpenzimet që financohen nga granti dhe ato që financohen nga të ardhurat. Shpenzimet që financohen nga granti duhet të jenë të përputhura me detajimin e dërguar nga Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave. Plani i shpenzimeve që financohet nga të ardhurat vendore shërben si limit shpenzimesh, i cili do të ndiqet nga dega e thesarit dhe do të përdoret kundrejt të ardhurave të realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Në rast të mosrealizimit të të ardhurave nga njësitë e qeverisjes vendore, rishikimi i limitit bëhet nga këshillat përkatës të njërive të qeverisjes vendore.

Njësitë e qeverisjes vendore duhet të depozitojnë strukturën dhe numrin e punonjësve në degën e buxhetit përkatëse, në momentin kur depozitojnë pranë kësaj dege vendimin e këshillit të kësaj njësie për miratimin e buxhetit. Një kopje i dërgohet për njoftim Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

Çdo ndryshim i buxhetit gjatë periudhës vjetore do të ndjekë të njëjtën rrugë procedurale të miratimit të buxhetit të fillimit të vitit. Organet e qeverisjes vendore kanë të drejtë, sipas ligjit të buxhetit vendor, të bëjnë rishikimin e buxhetit të miratuar në përputhje me realizimin e të ardhurave dhe me ndryshimin e prioritetëve gjatë vitit.

Në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003, njësitë e qeverisjes vendore i bëjnë publike të gjitha vendimet e këshillave të organeve të pushtetit vendor që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve që u vihen në dispozicion nga pushteti qendror, si dhe të fondeve të krijuara nga burimet e veta.

Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, së bashku me Ministrinë e Financave nxjerrin udhëzim të përbashkët për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me zbatimin e buxhetit të organeve të qeverisjes vendore.

IV.2 Buxheti i sigurimeve shoqërore

Buxheti i Shtetit transferon në buxhetin e sigurimeve shoqërore kontribute për kategoritë e mëposhtme:

- Personat që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Kontributet llogariten mbi pagën e realizuar nga ushtaraku para se të fillonte shërbimin e detyrueshëm në përqindjet e caktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, por jo më pak se masa minimale e kontributit, përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave.

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore depoziton në degën e thesarit Tiranë planin vjetor të kontributeve për ushtarët, të ndarë në dymujorë. Financimet nga buxheti bëhen çdo muaj, sipas planit. Në muajt maj, shtator dhe janar të vitit pasardhës, ISSH-ja paraqet në degën e thesarit, evidencën e numrit mesatar të ushtarëve për katërmujorin e mëparshëm, të konfirmuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik. Diferencat midis financimeve të tërhequra sipas planit dhe financimeve faktike sistemohen në muajin pasardhës të çdo katërmujori. Brenda muajit

prill të çdo viti, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik dërgojnë pranë ISSH-së listat emërore të ushtarëve, për efekt të evidentimit të periudhës së sigurimit.

- Për personat që trajtohen me pagesë papunësie, kontributet llogariten mbi pagën minimale, të përcaktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

- ISSH-ja njofton në degën e thesarit për çdo muaj, në momentin e tërheqjes së financimeve, numrin e personave që trajtohen me pagesë papunësie, të konfirmuar dhe nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Mbi bazën e kësaj evidence dhe kërkesës së ISSH-së bëhet kalimi nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e pavarur të sigurimeve shoqërore.

- Për personat që paguhen me pagesë kalimtare, sipas ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, kontributet llogariten mbi pagën e realizuar nga këta persona, para se të fillonte trajtimi me pagesë kalimtare dhe në përqindjet e përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.3.1993. ISSH-ja, njofton në degën e thesarit përkatëse çdo muaj, në momentin e tërheqjes së financimeve, numrin e personave që trajtohen me pagesë kalimtare, të konfirmuar nga Drejtoria e Sigurimit Suplementar në ISSH. Mbi bazën e kësaj evidence dhe kërkesës së ISSH-së, bëhet kalimi i fondit nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e pavarur të sigurimeve shoqërore.

Për ushtarakët e liruar që trajtohen sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kontributet llogariten mbi pagën e realizuar nga këta persona para se të fillonte trajtimi financiar nga dispozitat e ligjit të sipërshënuar dhe në përqindjet e caktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. ISSH-ja njofton në degën e për çdo muaj, në momentin e tërheqjes së financimeve, numrin e ushtarakëve që trajtohen me pagesë të parakohshme, të konfirmuar nga Drejtoria e Sigurimit Suplementar pranë ISSH-së. Mbi bazën e evidencës dhe kërkesës së ISSH-së, bëhet kalimi i fondit nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e pavarur të sigurimeve shoqërore. Kalimi i këtyre fondeve bëhet çdo muaj nga dega e thesarit Tiranë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke kërkuar zbatimin e kriterëve të përshkruara në aktet ligjore e nënligjore përkatëse si për:

Kompensimet, pensionet e posaçme shtetërore, shpërblimet për veteranët, shpërblimet për invalidët e punës, pagesat e pensioneve suplementare të ish-funksionarëve, pagesat e pensioneve suplementare dhe të parakohshme të ushtarakëve, pagesat e parakohshme të minatorëve, shpërblim për familjet e dëshmorëve.

- Transfertat në buxhetin e pavarur të ISSH-së, si diferencë midis shpenzimeve dhe të ardhurave për buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, transferohen nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e sigurimeve shoqërore, me kërkesën e ISSH-së dhe sipas planit vjetor të detajuar për katërmujorë dhe muaj.

IV.3 Buxheti i sigurimeve shëndetësore

Buxheti i Shtetit transferon në buxhetin e sigurimeve të kujdesit shëndetësor kontribute për sigurimin shëndetësor për personat joaktivë sipas përcaktimit të tyre bërë me ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore”, si dhe fonde të tjera nga Buxheti i Shtetit, të cilat miratohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave për çdo rast.

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor bën detajimin në dymujorë të planit të kontributit të transferuar nga Buxheti i Shtetit, referuar dhe konform detajimit të këtij plani në katërmujorë të miratuar nga Ministria e Financave. Ky detajim në nivel dymujor dërgohet në degën e buxhetit Tiranë në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të ISKSH-së.

Financimi i planit të miratuar do të kryhet çdo muaj në ISKSH nga dega e thesarit, Tiranë. Fondi i planifikuar për dymujorin e parë të vitit kalon në formë paradhënie në ISKSH dhe bartet për periudhën në vazhdim. Fondi për muajin pasardhës financohet në bazë të situacionit faktik të muajit paraardhës. Diferencat mes financimit të tërhequr sipas planit dhe financimeve faktike sistemohen në bazë të situacionit faktik progresiv në dymujorin e fundit të vitit, por në asnjë rast nuk do të financohet mbi planin vjetor të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

IV.4 Buxheti i pushtetit gjyqësor

Në zbatim të ligjit nr.8363, datë 1.7.1998 "Për krijimin e Zyrës së administrimit të buxhetit gjyqësor", dhe të ligjit nr.8379, datë 27.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", detajimi fillestar i fondit të miratuar do të bëhet nga Zyra e administrimit të buxhetit të pushtetit gjyqësor nëpër degët e buxhetit përkatëse. Transferimet për shpenzimet korrente dhe kapitale do të kryhen nga kjo zyrë dhe do të zbatohen nga degët e buxhetit kur ato janë të konfirmuara nga Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave. Në të gjitha rastet e transferimeve do të zbatohen afatet dhe procedurat e përcaktuara më sipër në këtë udhëzim.

V. VENDIMET GJYQËSORE

Për vendimet gjyqësore do të veprohet në përputhje me vendimin nr.335, datë 2.6.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit", si dhe akte të tjera nënligjore në këtë drejtim. Të gjitha institucionet buxhetore janë të detyruara të marrin pjesë në të gjitha shkallët e gjykimit dhe të mbajnë përgjegjësi për rezultatin e tyre. Vendimet gjyqësore zbatohen me buxhetin e miratuar të institucioneve, pasi njoftohet titullari i ministrisë/institucionit qendror nga varet institucioni. Këto institucione analizojnë të gjitha vendimet që sjellin dëm efektiv për Buxhetin e Shtetit dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësisë.

VI. MBYLLJA E BUXHETIT TË VITIT 2003

Buxheti i Shtetit i vitit 2003 rakordohet në nivel grupi, titulli, kapitulli e artikulli, sipas qarqeve e lokaleve, përfshi edhe limitin e të ardhurave të institucioneve buxhetore.

Deri më datën 20 shkurt 2004, në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave, evidentohen të gjitha shkresat e ndryshimit të planit të buxhetit të vitit 2003, duke i pasqyruar në kompjuter. Në të njëjtën kohë, çdo specialist përgatit edhe dosjen me shkresat përkatëse. Po kështu, brenda këtij afati veprohet edhe nga specialistët e buxhetit të ministrive të linjës/institucioneve qendrore.

Degët e buxhetit dhe degët e thesarit përfundojnë rakordimin midis tyre deri në 20 janar 2004 dhe një kopje të rakordimit e depozitojnë në Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave, në të njëjtën kohë me dorëzimin e raportit përfundimtar nga degët e thesarit.

Gjatë muajve shkurt dhe mars, Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave, sipas programit përkatës të hartuar për këtë qëllim, rakordon me degët e buxhetit dhe ministrinë e linjës/institucionet qendrore e më pas mbahet aktrakordimi. Kur ka raste të shpenzimeve mbi ose jashtë planit, mbahet procesverbal. Në raste të argumentuara, për efekt të rakordimit dhe kur veprimi nuk sjell pasoja financiare, bëhen sisteme nga Drejtoria e Buxhetit të Ministrisë së Financave.

Referuar nenit 53 të ligjit të buxhetit nr.8379, datë 29.8.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji. Në kuptim të ligjit si më sipër, çdo udhëzim i ministrive të linjës/institucioneve qendrore që bie ndesh me këtë udhëzim është i pazbatueshëm nga degët e buxhetit dhe të thesarit dhe nga vetë institucionet buxhetore.

Për efekt të transparencës në veprimet me buxhetin dhe thesarin, në hyrje të degëve të buxhetit dhe thesarit në rrethe vendoset njoftimi bashkëngjitur.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Pika e kontaktit në Drejtorinë e Buxhetit: Sektori i analizave dhe politikave buxhetore
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë Tel/Fax: 42 696 50; 42 229 20
E-mail: budget.director@minfin.gov.al

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

Të nderuar punonjës të administratës publike
Të nderuar përfaqësues të subjekteve private

Në degët e buxhetit dhe thesarit do të paraqiten vetëm punonjës të administratës publike. Ndalohet rreptësisht hyrja në degën e buxhetit ose thesarit dhe kryerja e veprimeve nga ana e përfaqësuesve të firmave private apo përfituesve të tjerë të fondeve buxhetore. Çdo rast në kundërshtim me këtë rregull do të përbëjë shkelje të disiplinës në punë dhe do të ndëshkohet me masa administrative deri në largim nga puna.

Për çdo veprim në kundërshtim me këto rregulla njoftoni menjëherë në numrin e telefonit:

Ministria e Financave
Tel/Fax ; 04 228938, 04 228373

Aneks 1

Struktura buxhetore e Pushtetit vendor për vitin 2004

Gr	Tit	Emër titulli	Kap	Funksionet
74	073	Ujësjiellës-kanalizime		Pastrim gjelbërimi, dekorimi, mirëmbajtja, varreza, ndriçimi etj.
	074	Strehimi dhe urbanistika		
	135	Programe të turizmit		
	076	Shërbimet publike		
74	042	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)		Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, shkolla profesionale
	043	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)		
	044	Arsimi i mesëm (profesional)		
74	052	Shërbimet e kujdesit parësor		Poliklinikat dhe qendra shëndetësore, drejtoritë e higjienës, stomatologjia, DDD.
	053	Shërbimet e kujdesit dytësor		
	055	Shërbimet e shëndetit publik		
74	084	Zhvillimi i sportit		Institucionet lokale dhe kulturore dhe sportive
	085	Programe specifike kulturore		
74	064	Shërbimet e kujdesit social		Institucionet të kujdesit social dhe çerdhet.
74	123	Menaxhimi i transportit rrugor		Rrugët rurale dhe urbane, mirëmbajtja e rrugëve, subvencioni i transportit urban.
	126	Transporti publik		
74	137	Shërbime të tjera ekonomike		Repertitorët dhe shërbime të tjera
74	148	Shpenzime të tjera		Shpenzime të tjera të paparashikuara, fonde të paparashikuara, fonde të rasteve të emergjencave fondi rezervë.
74	19	Shërbime të përgjithshme publike		Aparatet e njësive të QV, këshilltarët, policia Bashkiake

VENDIM
Nr.1, datë 30.1.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 3.12.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.42 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP PREJ 1/5 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga deputeti Lekë Çukaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Sokol Shazi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

- Interpretimi i nenit 64/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 124 e 131/c të Kushtetutës, si dhe neni 49 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka paraqitur dy kërkesa në të cilat parashtrohet këto shkaqe:

- Neni 64/1 i Kushtetutës përcakton përpjesëtimin e përbërjes së Kuvendit në varësi të mënyrës së përfaqësimit të sovranitetit të popullit sipas mënyrës së zgjedhjes: 100 deputetë drejtpërdrejt nga zonat njëmërore dhe 40 nga listat shumëmemërore në bazë të rezultatit proporcional.

- Duke u zbatuar pika 3 e nenit 14 të Kodit Zgjedhor në një rast praktik, ndryshoi përbërja e Kuvendit për mënyrën e përfaqësimit, me 99 deputetë të zgjedhur nga zonat njëmërore dhe 41 nga listat proporcionale, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 64/1 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi, në seancë gjyqësore, duke konfirmuar shkaqet e kërkesës, e kufizoi objektin e saj vetëm për fjalinë e parë të pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, që ka këtë përmbajtje: “Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëmërore mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor përkatës”.

Gjykata Kushtetuese, para fillimit të seancës gjyqësore, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë të dy kërkesave të paraqitura nga grupi i deputetëve bëri, me një vendim të veçantë, bashkimin e tyre në një çështje të vetme. Në këtë mënyrë, kërkesa për interpretim abstrakt të nenit 64/1 të Kushtetutës merr zgjidhje nëpërmjet shqyrtimit e kontrollit të kushtetutshmërisë së pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor.

Nga përmbajtja e kërkesës dhe shqyrtimi i çështjes në seancë rezulton se Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor, pas mbarimit në mënyrë të parakohshme të mandatit të një deputeti për shkak të dorëheqjes, ka filluar procedurat për zëvendësimin e tij. Me shkresën nr.1974, datë 19.9.2003, Kuvendi i Shqipërisë ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kandidaturën zëvendësuese nga lista shumemërore e koalicionit “Bashkimi për fitore” dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka shpallur atë me vendimin nr.1846, datë 24.9.2003. Deputeti i shpallur ka bërë betimin në seancën plenare të datës 14.10.2003.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore të përcaktuar në objektin e kërkesës të analizojë disa aspekte që lidhen me sistemin zgjedhor, me mënyrën dhe procedurat e zgjedhjes së deputetëve dhe të zëvendësimit të tyre në rastet e mbarimit të parakohshëm të mandatit, si dhe rregullimin juridik të tyre në periudhën postkomuniste si para, ashtu edhe pas miratimit të Kushtetutës.

Sipas ligjit të zgjedhjeve të vitit 1992, Kuvendi përbëhej nga jo më pak se 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëmërore, kurse mandatet shtesë kompensuese, sipas një formule të caktuar, u jepeshin kandidatëve në listat e subjekteve sipas proporcionit të votave të fituara në raundin e parë.

Ligji i zgjedhjeve i vitit 1997 ndryshoi atë të vitit 1992 në përcaktimin e numrit të deputetëve nga jo më pak se 140 në 115 deputetë, ndryshim që çoi në rritjen e numrit të deputetëve që zgjidhen nga listat njëmërore në 115. Ndryshoi edhe përqindja e minimumit të votave për proporcionalin nga 4 % në 2 %.

Ligjet e mëvonshme, të dala pas miratimit të Kushtetutës, në formën e kodeve zgjedhore që janë ai nr.8609, datë 8.5.2000 dhe nr.9087, datë 19.6.2003, i përmbahen sistemit zgjedhor të përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, pra sistemit të përzier.

Duke e parë problemin e sistemit zgjedhor në mënyrë kronologjike sipas ligjeve zgjedhore të dala për një periudhë mbi 10-vjeçare, rezulton se pavarësisht nuancave të veçanta, përgjithësisht është zbatuar sistemi i përzier, ku elementet maxhoritare janë më të dukshme, kurse elementet e sistemit proporcional kanë synuar të zbusin ndonjë shpërpjesëtim të shkaktuar nga sistemi maxhoritar.

Lidhur me zëvendësimin e një deputeti për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit, zgjidhjet ligjore, në periudha të ndryshme, kanë veçoritë e tyre. Në nenin 81 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 parashikohej se në rast të mbarimit para afatit të mandatit të deputetit, Komisioni i Mandateve shpall të zgjedhur kandidatin e radhës në listën në shkallë vendi. Kur deputeti nuk përfaqëson një subjekt që ka lista në shkallë vendi, në zonën e tij kryhen zgjedhje brenda 3 muajve. Kur deputeti merr përsipër një detyrë tjetër që nuk pajtohet me mandatin e tij, zëvendësohet nga kandidati i radhës në listën përkatëse në shkallë vendi.

Kurse Kodi Zgjedhor i vitit 2000, në nenin 11, parashikonte plotësimin e vendit vakant të deputetit në dy mënyra, në varësi të zgjedhjes së tij. Kur deputeti ishte zgjedhur nga lista shumemërore, plotësimi bëhej nga kandidati i radhës në listë, ndërsa për deputetin e zgjedhur në zonën njëmërore, zëvendësimi bëhej nga një deputet i ri i zgjedhur nga zgjedhjet e së njëjtës zonë. Sipas pikës 4 të këtij neni, kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë njëmërore mbaron në mënyrë të parakohshme gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit, plotësimi bëhet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.

Në nenin 14 të Kodit të ri Zgjedhor, i cili është edhe objekt i kërkesës, ka një rregullim të ndryshëm përse i përket plotësimit të vendit të deputetit të zgjedhur në një zonë njëmërore. Në këtë rast, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.

Krahasimi i përmbajtjes së këtyre dy dispozitave ligjore evidenton qartë një dallim thelbësor mes tyre. Në rastin e parë janë përcaktuar zgjidhje të ndryshme të plotësimit të vendit të deputetit në varësi të mënyrës së zgjedhjes, kurse në rastin e dytë, pavarësisht nga mënyra e zgjedhjes, zëvendësimi është i njëjtë: nga listat shumëmemërore.

Duke bërë të qartë këtë dallim, çështja shtrohet nëse përmbajtja e fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 vjen në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës, apo formulimi i ri është më i përshtatshëm dhe nuk cenon raportet kushtetuese të përfaqësimit brenda sistemit të përzier zgjedhor.

Sistemi i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, është një sistem i përzier me elemente të maxhoritarit që janë mbizotëruese dhe i plotësuar me elemente proporcionale. Kjo për faktin se nga numri i përgjithshëm prej 140 deputetë, 100 prej tyre zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëmemërore dhe 40 nga listat shumëmemërore të partive ose të koalicioneve të partive. Zgjedhja e mbi 2/3 të deputetëve në zonat njëmemërore dhe marrja për bazë e këtyre rezultateve në ndarjen e mandateve plotësuese, përcaktimi i numrit maksimal të deputetëve pa lejuar rritjen e tij dhe mënyra e ndarjes së mandateve plotësuese, sipas paragrafit të dytë të nenit 64 të Kushtetutës, në një raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra në të gjithë vendin, përbëjnë elementet e një sistemi të përzier zgjedhor, në të cilin ndikimin më të madh e kanë elementet maxhoritare. Për të plotësuar kuadrin e këtij sistemi të përzier, në pikën 3 të nenit 64 të Kushtetutës, është parashikuar përjashtimi nga përfitimi prej listave shumëmemërore i partive dhe i koalicioneve që marrin përkatësisht më pak se 2.5 % dhe 4 % të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve.

Në përcaktimin e një sistemi zgjedhor duhet të merren në konsideratë shumë faktorë, siç janë ata historikë, politikë, etnikë, kulturorë, shoqërorë ose gjeografikë. Çdo sistem zgjedhor në një shoqëri demokratike synon të sigurojë stabilitet dhe qeverisje efektive e të qëndrueshme dhe njëkohësisht të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë të popullit dhe një shprehje sa më të plotë të vullnetit të tij. Në parim, çdo sistem zgjedhor konsiderohet në tërësinë e tij demokratik, në qoftë se nëpërmjet tij respektohen të gjitha rregullat e një konkurrimi të drejtë e të barabartë.

Në radhë të parë, sistemi zgjedhor dhe procedurat që lidhen me zbatimin e tij duhet të garantojnë e të vënë në zbatim përfaqësimin real të komunitetit dhe ushtrimin adekuat të sovranitetit të popullit.

Neni 2 i Kushtetutës, duke sanksionuar sovranitetin e popullit si një parim të rëndësishëm kushtetues, në pikën 2, përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të tij nëpërmjet përfaqësuesve ose drejtpërsëdrejti. Përfaqësimi i popullit në Kuvend bëhet sipas nenit 64 të Kushtetutës me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të deputetëve në çdo zonë zgjedhore. Fitues është ai që ka marrë numrin më të madh të votave, të cilat shprehin dëshirën dhe vullnetin e popullit. Kandidatët e listës zgjidhen sipas renditjes që bën subjekti zgjedhor.

Në zbatim të nenit 64 të Kushtetutës, i gjithë vendi është ndarë në 100 zona zgjedhore me numër të përafërt zgjedhësish dhe çdo zonë ka përfaqësuesin e vet si deputet në Kuvend. Zëvendësimi, qoftë edhe i një deputeti të zgjedhur në zonën njëmemërore me një tjetër të listës proporcionale, cenon raportin e përcaktuar nga Kushtetuta. Vlerësimi i elementeve që i përkasin aspektit proporcional në një sistem zgjedhor të përzier nuk duhet të prekë në mënyrë thelbësore elementin tjetër bazë të sistemit, prandaj është kusht “sine qua non” që në çdo dispozitë ligjore të bëhen rregullimet e nevojshme, pa prekur kriteret dhe raportet e vendosura nga Kushtetuta. Përmbajtja e fjalisë së parë të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor prek pikërisht ato raporte të vendosura në Kushtetutë, prandaj është e papajtueshme me të.

Meqënëse me shfuqizimin e dispozitës objekt kërkesë krijohet boshllëk ligjor, lidhur me mënyrën e zëvendësimit të deputetit të zgjedhur në zonën njëmemërore, i takon Kuvendit të Shqipërisë të bëjë plotësimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a e 134/c të

Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me këtë përmbajtje: “Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëemërore mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumëemërore të subjektit zgjedhor përkatës.”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.2, datë 3.2.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Pilloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 24.1.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.213/13/1 Akti që i përket:

KËRKUES: AVOKATI I POPULLIT, Ermir Dobjani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Genc Çifligu.

SHOQËRIA “ISMAILI” SHPK, në mungesë.

DHOMA E TREGTISË TIRANË, përfaqësuar nga Luan Bregasi.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga Petrit Ago.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të pikave 3 e 5 të nenit 289 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Neni 134/dh i Kushtetutës, neni 24/c i ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe neni 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Avokati i Popullit ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikave 3 e 5 të nenit 289 të Kodit Doganor, për këto shkaqe:

- Rregullat që përmbajnë dispozitat e mësipërme, sipas të cilave lejohet ankimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe në gjykatë, vetëm pas pagimit të gjobës dhe të detyrimit doganor, mohojnë realisht të drejtën e ankimit.

- Këto dispozita vijnë në kundërshtim me nenin 13 të Konventës Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut” dhe me nenin 8 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të cilat

parashikojnë të drejtën e një ankimi efektiv përpara një instance kombëtare kur personit i cenohen të drejtat themelore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Shoqëria "Ismaili" sh.p.k., ka paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit një ankesë, në të cilën ka parashtruar se është gjykuar padrejtësisht për kundërvajtje nga Drejtoria e Doganave Tiranë, duke u detyruar me shumë prej 13 000 000 lekë që përfaqëson gjobën dhe detyrimin doganor të papaguar. Në ankesën e saj, ajo ka parashtruar gjithashtu se i është mohuar e drejta e ankimit kundër vendimit të dhënë për kundërvajtje, pasi autoritetet doganore i kanë vënë si kusht pagimin paraprakisht të shumës së sipërme, duke iu referuar pikave 3 e 5 të nenit 289 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

Avokati i Popullit ka pretenduar se me kërkesën e paraqitur për shqyrtim legjitimohet që të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134 pika 1 shkronja "dh" të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 shkronja "c" të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar Kushtetutës, dispozitave të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe jurisprudence së saj, çmon se Avokati i Popullit nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës.

Subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 134 të Kushtetutës ndahen në dy grupe. Avokati i Popullit bën pjesë në grupin e dytë ku, krahas tij, përfshihen edhe subjekte të tjera, si organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike, shoqatat dhe individët. Subjektet e këtij grupi, në bazë të pikës 2 të nenit të mësipërm të Kushtetutës, ndryshe nga subjektet e grupit të parë, të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese e kanë të kufizuar "vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre".

Gjykata Kushtetuese çmon se rëndësi të veçantë ka përcaktimi i çështjeve që lidhen me interesat për të cilat Avokati i Popullit ka të drejtë të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Përcaktime të tilla janë bërë fillimisht me vendimin nr.49, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është interpretuar pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës. Sipas këtij vendimi interpretues, Avokati i Popullit ka të drejtë të parashtrojë në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare; për papajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, si dhe për interpretimin e Kushtetutës, por vetëm kur në këto raste çështja lidhet me interesat e tij. Në këtë vendim, si çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit konsiderohen shkeljet e rregullave kushtetuese, që kanë të bëjnë me organizimin e funksionimin e institucionit të tij, parashikuar në nenin 60 paragrafi i dytë dhe i tretë, në nenet 61 e 62 të Kushtetutës.

Dispozitat e ligjit që kërkohet të shfuqizohen trajtojnë çështje të fushës së doganave. Ato nuk kanë lidhje me organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk e prekin atë. Në këto kushte, Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, sepse ajo nuk ka lidhje me interesat e tij.

Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Gjykata Kushtetuese edhe me vendimin nr.178, datë 8.11.2001, për çështjen me objekt shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8377, datë 22.7.1998 "Për shpalljen e moratoriumit të detyrimeve të pashlyera të ish-ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme". Me këtë vendim është rrëzuar kërkesa që ka paraqitur Avokati i Popullit me arsyetimin se asnjë normë e këtij ligji nuk kishte prekur "strukturën organizative të institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk kishte penguar statusin e tij si person juridik, rrethana këto që përmenden në mënyrë indikative në vendimin interpretues nr.49, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese".

Vendosja e Avokatit të Popullit në grupin e dytë të subjekteve që kanë të drejtë të vënë në

lëvizje Gjykatën Kushtetuese në mënyrë të kufizuar shpjegohet me faktin se Avokati i Popullit është një institucion i krijuar për mbrojtjen e të drejtave të individit në fushën e veprimtarisë të administratës publike dhe jo të Kuvendit. Kjo del edhe nga përmbajtja e nenit 25 të ligjit organik “Për Avokatin e Popullit”, ku ligjet dhe disa akte të tjera janë lënë jashtë juridiksionit të tij.

Kërkuesi pretendon se legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese edhe sipas nenit 24 shkronja “c” të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, me argumentin se kjo dispozitë i jep të drejtën që t’i bëjë Gjykatës Kushtetuese rekomandime për shfuqizimin e akteve ligjore dhe se, sipas tij, rekomandimi duhet të njësohet me kërkesën. Ky pretendim është i pabazuar.

Termi “kërkesë” është i ndryshëm nga termi “rekomandim”. Proceduralisht gjykatat vihen në lëvizje për shqyrtimin e çështjeve të kompetencës së tyre nëpërmjet kërkesëpadive dhe jo nëpërmjet rekomandimeve. Edhe Gjykata Kushtetuese nuk mund të vihet në lëvizje me rekomandimin e Avokatit të Popullit, sepse mjeti që e vë në lëvizje atë është vetëm kërkesa. Sipas nenit 134 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje “vetëm me kërkesë” të subjekteve të parashikuara në këtë dispozitë, ku bën pjesë edhe Avokati i Popullit. Kërkesa e paraqitur nga subjektet e parashikuara në dispozitën e mësipërme, ndryshe nga rekomandimi, ka karakter detyrues. Ajo e ngarkon Gjykatën Kushtetuese me detyrimin që të shqyrtojë çështjen e paraqitur sipas procedurave të parashikuara nga ligji i saj organik dhe në përfundim të japë vendimin përkatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam krejtësisht kundër vendimit të shumicës.

1. Në këtë çështje dalin dy probleme, por i pari dhe kryesori është legjitimitimi.

Me fjalë të tjera: A legjitimohet Avokati i Popullit të kërkojë përpara Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e një ligji si antikushtetues, kur nga ushtrimi i funksioneve të tij ka dalë se administrata publike shkel të drejtat e njeriut si rezultat i zbatimit të një ligji antikushtetues?

Sqarimi i këtij problemi merr rëndësi të posaçme, veçanërisht, për shkak të qëndrimeve që ka mbajtur ndaj këtij problemi Gjykata Kushtetuese në vendime të ndryshme.

a) Në vendimin nr.43, datë 31.7.2002, i cili është vendim interpretues, pranohet në analizë të fundit legjitimitimi i Avokatit të Popullit për ato çështje, citoj: “kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, e aktit normativ e nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike ... janë cenuar të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, shkelje këto të konstatuara në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten, etj.”.

b) Në vendimin tjetër, për një çështje konkrete (nr.178, datë 8.11.2001) Gjykata Kushtetuese shprehet kundër legjitimitit të Avokatit të Popullit për të kërkuar papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën (duke bërë përjashtim vetëm për ligjet që lidhen me vetë veprimtarinë e vetë organit). Në vendim, ndër të tjera, theksohet se Avokati i Popullit nuk mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese kur nuk del që një ligj citoj: “të ketë prekur strukturën organizative të organit që ka

drejtuar, të ketë cenuar sadopak statusin e tij si person ose të punonjësve të tjerë të institucionit, apo t'i ketë penguar ata në ushtrimin e kompetencave që kanë lidhje me funksionet e tij". Më tej, vendimi mban qëndrim kategorik se "pa qenë të pranishme këto rrethana, Avokati i Popullit nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe ta investojë atë në shqyrtimin e çështjes". Në vendim përdoren edhe argumente të tjera, por baza mbetet ai i cituar më sipër. Në vendimin tjetër nr.26, datë 24.4.2001, Gjykata Kushtetuese pranon shfuqizimin e një akti normativ si burim i shkeljeve kushtetuese, kërkuar nëpërmjet Avokatit të Popullit.

Në këto kushte, ende pa u futur tek analiza e dispozitave kushtetuese, pa dhënë argumente në rastin teorik dhe pa iu referuar tendencave e praktikave ndërkombëtare, pyetja shtrohet: Cilin vendim do të marrim për bazë ne, Avokati i Popullit, juristët, avokatët apo edhe qytetarët? Do të marrim për bazë një vendim interpretimi të Gjykatës Kushtetuese që është pjesë integrale e vetë Kushtetutës dhe burim i mirfilltë i së drejtës kushtetuese, apo një vendim po të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka të bëjë me një çështje konkrete dhe që nuk ka për objekt të drejtpërdrejtë interpretimin apo riinterpretimin e dispozitës kushtetuese?

Për mua, pa as më të voglin ekuivok, për bazë duhej të merrej vendimi interpretues për atë natyrë e cila u theksua më lart.

Ky është argumenti i parë, baza për pranimin e legjitimitetit të Avokatit të Popullit.

2. Vetë Kushtetuta, si kusht themelor për ndërhyrjen e Avokatit të Popullit parashikon "... veprime të paligjshme apo të parregullta të administratës publike ...".

A i gjejmë këto premisa të çështja objekt shqyrtimi?

Mendoj se po.

Nuk besoj të ketë kundër, për faktin se administrata doganore ndaj të cilit është bërë ankimi është administratë publike. Por, unë njëkohësisht mendoj se nuk mund të qëndrojë arsyetimi që ndërsa ndaj akteve apo veprimeve të kundërligjshme Avokati i Popullit mund të reagojë qoftë edhe duke ngritur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, kurse ndaj akteve apo veprimeve antikushtetuese Avokatit të Popullit i mungojnë kompetencat. Unë do të thosha se problemi i ligjshmërisë në kuptimin e gjerë përfshin edhe antikushtetutshmërinë dhe në këtë kuptim aktet apo veprimet e administratës publike, të cilat janë të bazuara në ligje antikushtetuese, përbëjnë veprimtari antikushtetuese e si të tilla janë objekt i veprimtarisë së Avokatit të Popullit, kurse ligjet ku ato mbështeten janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

3. Në ndihmë të qëndrimit të mësipërm vjen edhe qëndrimi i mbajtur në literaturën tonë juridike. "... në Gjykatën Kushtetuese Avokati i Popullit mund të kërkojë vetëm shqyrtimin e ligjit antikushtetues që është bërë bazë e cenimit të të drejtave të individit nëpërmjet akteve të administratës. Kontrolli në këto raste do të kishte më shumë natyrë objektive dhe vendime me fuqi të përgjithshme". Kështu e trajton këtë problem Kristaq Traja në librin "Drejtësia Kushtetuese", faqe 264.

4. Në shqyrtimin e interpretimin e dispozitave që kanë të bëjnë me kompetencat e Avokatit të Popullit nuk mund të anashkalohen rrethanat sociale. Unë shtroj pyetjen: Nëse individit i është shkelur një e drejtë kushtetuese si pasojë e një ligji antikushtetues, a nuk paska të drejtë ai të realizojë të drejtën e tij nëpërmjet një organi të posaçëm, i cili është krijuar dhe ekziston pikërisht për ta mbrojtur atë nga arbitraritetet e pushtetit.

Duke mbajtur pozicion të kundërt për këtë problem, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, me këtë vendim ravigjzohen dy qëndrime të cilat përbëjnë për mua një paradoks. Për të shfuqizuar një ligj si antikushtetues ne jemi vënë në lëvizje edhe nga shoqata (të mëdha e të vogla) mjafton që në statutet e tyre të kishin për detyrë mbrojtjen e interesave të anëtarëve. Edhe për rastin në fjalë, nuk kishte diskutim sikur këtë kërkesë ta bënte Dhoma e Tregtisë, Bashkimi i Biznesmenëve apo dhe ndonjë kryesi komuniteti fetar. Pengesa nëpërmjet interpretimeve i bëhen vetëm kompetencave dhe funksioneve të Avokatit të Popullit, i cili jo me statut e rregullore, por me Kushtetutë është subjekt kushtetues me funksione të posaçme në drejtim të mbrojtjes së të drejtave e lirive të qytetarëve.

5. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje pa shqyrtuar edhe tendencat e prirjet që vihen re sot në Europë e më gjerë lidhur me rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. E nëse ne themi që ne aspirojmë për në Europë, këto tendenca duhet t'i kemi parasysh. Nëse ne

kemi aspiratë futjen në Bashkimin European, nuk duhet të harrojmë se Bashkimi European ka një Kartë të të Drejtave të Njeriut, miratuar në Nicë, në dhjetor të vitit 2000, në nenin 43 të së cilës parashikohet ndërhyrja e Avokatit të Popullit për të gjitha keqadministrimet e institucioneve apo organeve të komunitetit me përjashtim të gjykatave.

Janë një sërë rekomandimesh të Këshillit të Europës (1985, 1997), ku theksi vihet veçanërisht tek, citoj: “Zgjerimi dhe forcimi i pushteteve të ombudsmanit në mënyra të tjera që të inkurajojnë një vëzhgim efektiv të të drejtave dhe lirive të njeriut në funksionin e administratës”. Tendencën e përgjithshme të forcimit të kompetencave të Avokatit të Popullit e gjejmë edhe në një sërë aktesh ndërkombëtare apo dhe kushtetuta.

Në këtë vështrim, kam qenë e jam për legjitimimin e Avokatit të Popullit.

ANËTAR
A. Karamuço

MENDIMI I PAKICËS

Nuk mund të jemi dakord me mendimin e shumicës, për arsye se me zgjidhjen që ka dhënë ajo e ka kufizuar të drejtën e Avokatit të Popullit për të qenë një subjekt që mund të iniciojë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate kjo përbënte një çështje të debatueshme të aspektit kushtetues, por me qëndrimin e mbajtur së fundi në këtë vendim, ndoshta për një periudhë kohe relativisht të gjatë, Avokati i Popullit nuk do të mund të përfshihet në axhendën e gjykimeve abstrakte që trajtojnë kushtetutshmërinë e ligjeve.

Për të inicuar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit është vetë Kushtetuta që ia njeht këtë të drejtë Avokatit të Popullit në nenin 134 të saj. Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj interpretues nr.49, datë 31.7.2000, ka pranuar se çështje që lidhen me funksionin kushtetues të Avokatit të Popullit janë edhe rastet kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike cenohen të drejtat e shtetasve. Gjithashtu në nenin 49 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” nuk mohohet kjo e drejtë. Ky ligj shkon edhe më tej, kur në nenin 52 i njeh Avokatit të Popullit të drejtën për të kërkuar papajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit, ndërsa në nenin 71 e njeh edhe si subjekt që kërkon interpretimin e Kushtetutës.

Shumica, në vendimin e saj, përpiket të arsyetojë se pengesë për të legjitimuar Avokatin e Popullit është vendimi interpretues, si dhe një vendim për një rast konkret të kësaj Gjykate. Paraprakisht sqarojmë se referenca kryesisht në vendimin interpretues bëhet në mënyrë parciale. Vendimi interpretues i Gjykatës Kushtetuese ka dy momente të rëndësishme:

Së pari, ai pranon se çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit do të jenë ato çështje që lidhen me funksionin kushtetues të tij “kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit e aktit normativ nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike këto interesa janë cenuar duke shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, shkelje këto të konstatuara në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij”.

Së dyti, “...në kuptim të nenit 134 paragrafi 2 të Kushtetutës, me interesa të Avokatit të Popullit do të konsiderohen edhe rastet e cenimit të këtyre rregullave kushtetuese, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij...”.

Shumica ka përdorur si argument kryesor pikën e dytë të sipërcituar duke e kondicionuar legjitimimin e Avokatit të Popullit vetëm për çështje që prekin drejtpërsëdrejti atë si person juridik në të drejtat e organizimit dhe funksionimit të organit që ai përfaqëson.

Nuk mendojmë se është e nevojshme që për të arsyetuar qëndrimin tonë të merremi vetëm me përmbajtjen e vendimeve të sipërcituara të Gjykatës Kushtetuese, pasi ato janë të botuara dhe gjithkush mund t'i analizojë, aq më tepër që këndvështrimet tona për argumentet janë të kundërta.

Në këto rrethana, përqendrimi tek elementet thelbësore që përmban neni 60 i Kushtetutës, të

analizuara dhe interpretuara në një kuptim të gjerë dhe nga një këndvështrim oponent ndaj vendimit të shumicës, mendojmë se i vlen argumenteve të një qëndrimi pakice.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”.

Kur Avokati i Popullit konstaton se janë shkelur të drejtat e individit nga veprimet e paligjshme të administratës publike, ai duhet të ndërhyjë. Ky është thelbi i veprimtarisë së tij. Sipas këtij neni të Kushtetutës, Avokati i Popullit duhet të dallojë paligjshmërinë apo parregullsinë në veprimet e organeve të administratës publike. Ai këtë funksion e realizon duke u ballafaquar me Kushtetutën e ligjin dhe kur bindet se këto veprime janë të paligjshme ose të parregullta, duhet të ndërhyjë. Gjithashtu, ai mund të rekomandojë që të evitohet kjo paligjshmëri në të ardhmen.

Pyetja që shtrohet në këtë rast është: Kur Avokati i Popullit, i cili është në gjendje të vlerësojë paligjshmërinë e një veprimi të administratës publike, bindet se kjo paligjshmëri që ka cenuar individin rrjedh nga antikushtetutshmëria e ligjit të zbatuar, atëherë a mund ai të heshtë, apo duhet të ndërhyjë që shtetasit të mos dhunohen në të drejtat e tyre?

Koncepti i paligjshmërisë nuk duhet reduktuar vetëm në zbatimin e gabuar apo moszbatimin e ligjit. Paligjshmëria është një koncept shumë më i gjerë. Paligjshmëria është një koncept që lidhet edhe me antikushtetutshmërinë dhe është pjesë përbërëse e saj. Përpara paligjshmërisë do të ndodhemi edhe kur një organ zbaton një ligj dhe kryen një veprim që sipas Avokatit të Popullit nuk është në përputhje me Kushtetutën, sepse individit nga ky veprim mund t’i cenohet një e drejtë. Nëse nga ekzistenca e një ligji që pretendohet si antikushtetues cenohen të drejtat e individëve, Avokati i Popullit nuk duhet të qëndrojë indiferent. Përkundrazi, ai duhet të veprojë duke ndërhyrë me mjetet e tij juridike. Kjo përbën thelbin e veprimtarisë së tij dhe një nga mjetet që Kushtetuta atij i ka dhënë është dhe inicimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj në konceptin kushtetues të veprimeve të paligjshme të organeve të administratës publike përfshihen edhe ato raste kur organet administrative, nëpërmjet zbatimit të një ligji që mund të jetë antikushtetues, cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.

Funksioni kryesor i Avokatit të Popullit është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të shtetasve. Konstatimi nga Avokati i Popullit i rasteve kur cenohen të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve përfshihet në juridiksionin e tij dhe kjo lidhet plotësisht me interesat e tij si organ kushtetues. Mjetet juridike që ai përdor, si kërkesa, raportimi, rekomandimi e propozimi nuk kanë të bëjnë me kompetencat. Kërkesa që Avokati i Popullit ushtron për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën nuk përbën pushtet kontrolli ndaj veprimtarisë së Kuvendit, siç arsyeton shumica. Ashtu siç nuk përbën pushtet kontrolli ndaj ekzekutivit e drejta e tij për të kërkuar para Gjykatës Kushtetuese papajtueshmërinë e akteve normative të Këshillit të Ministrave. Kërkesa ose rekomandimi për të vendosur në vend ligjin e shkelur nuk mund t’i ndalohen për t’i përdorur një individ çfarëdo dhe aq më tepër Avokatit të Popullit. Kërkesa për t’iu drejtuar një institucioni (locus standi) nuk është pjesë e kompetencës lëndore. Legjitimimi është një koncept juridik që lidhet me interesin dhe jo me kompetencën.

Nga pikëpamja formale, neni 134 pika 2 e Kushtetutës është i zbatueshëm në këtë rast, lidhur me të drejtën e këtij subjekti për të inicuar një gjykim kushtetues. Ky nen i Kushtetutës kërkon një lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit të kontestuar për antikushtetutshmëri dhe interesit të subjektit përkatës. P.sh. interesi i subjekteve që parashikohen në këtë dispozitë kushtetuese duhet parë në aspektin nëse ligji që kontestohet ka lidhje me funksionin për të cilin ato subjekte janë krijuar. Një organ i qeverisjes vendore apo një organ i bashkësisë fetare duhet të provojë përpara Gjykatës Kushtetuese interesin që ka me ligjin konkret. Shoqatat, të cilat në praktikën e Gjykatës Kushtetuese janë legjitimuar si subjekte, mjafton të provojnë përpara saj se kanë një lidhje me ligjin objekt shqyrtimi që ato të konsiderohen të legjitimuara.

Përgjithësisht ky është qëndrimi që jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka mbajtur në raste të tilla. Gjykata Kushtetuese nuk mund të analizojë te këto subjekte kompetencën lëndore, sepse jo të gjithë e kanë të përcaktuar atë. Ajo vlerëson interesin që kanë këto subjekte me çështjen në shqyrtim. Përsa i përket Avokatit të Popullit, i cili funksion kryesor ka konstatimin e rasteve të

dhunimeve të të drejtave dhe lirive të shtetasve, bëhet përjashtimi nga ana e shumicës, duke ia mohuar përdorimin përpara Gjykatës Kushtetuese të të vetmit mjet juridik efikas. Ky qëndrim i shumicës e lë pa efektivitet veprimtarinë e Avokatit të Popullit në rastet kur aktet e organeve të administratës publike, megjithëse bazohen në ligj, shkelin të drejtat themelore të shtetasve. Këto raste nuk janë të pakta në praktikë në kushtet kur neni 118/2 i Kushtetutës sanksionon një lidhje të domosdoshme midis kërkesave të ligjit dhe aktit nënligjor.

Jo pa qëllim Kushtetuta i ka dhënë këtij organi një vend të rëndësishëm. Në qoftë se do të ekzistonte vetëm neni 60 i Kushtetutës nuk do të kishte asnjë lidhje midis Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Kushtetuese. Pikërisht është neni 134 i saj që i njeh të drejtën e një gjykimi abstrakt edhe Avokatit të Popullit, mjafton që ai të vërtetojë interesin në çështjen konkrete dhe jo kompetencën.

Edhe sipas legjislacionit ndërkombëtar, Avokati i Popullit (ombudsmani) këtë funksion ka, por megjithatë ai mund të kërkojë iniciimin e një gjykimi kushtetues për antikushtetutshmërinë e ligjit.¹ Të gjitha referencat në ligjet e vendeve të tjera japin dhe një tendencë që ekziston në këtë drejtim, nga e cila nuk mund të përjashtohet Republika e Shqipërisë.

Pra, Avokati i Popullit fushën e tij të veprimtarisë e ka të fokusuar tek mbrojtja e të drejtave dhe lirive të shtetasve nga veprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës. Avokati i Popullit sipas Kushtetutës mbron pikërisht shtetasit nga shkelja që u bëhen të drejtave dhe lirive të tyre dhe ka këtë funksion kryesor. Mjeti që duhet përdorur për të eliminuar këtë cenim duhet të jetë kushtetues. Neni 134 i Kushtetutës ia njeh këtë të drejtë Avokatit të Popullit.

ANËTAR
K. Puto

ANËTAR
S. Sadushi

VENDIM
Nr.210, datë 30.1.2004

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “abc”
SUBJEKTIT: Z. ARMAND BAZE

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin dhjetor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Armand Baze me vendndodhje në Korçë, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

¹ Po të shohim ligjin slloven do të vemë re një përputhje me Kushtetutën tonë. Ombudsmani slloven përcakton paligjshmërinë ose parregullsinë në organet e administratës publike dhe i propozon atyre eliminimin e këtyre parregullsive. Një ndër mjetet që ai përdor është edhe iniciimi i gjyqimeve për antikushtetutshmërinë e ligjit në Gjykatën Kushtetuese. E rëndësishme është për praktikën e Gjykatës Kushtetuese sllovene që të ushtrojë një proces seleksionues mjaft serioz për të gjetur interesin e ligjshëm të ngritur në ankesë.

Ligji austriak ka akoma më shumë ngjashmëri me konceptin e Kushtetutës sonë. Neni 148/a thotë : Çdo njeri ka të drejtë të ankohet pranë institucionit të Avokatit të Popullit *për një shkelje të së drejtës së tij private nga veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës shtetërore*. Kjo përbën kompetencën lëndore të Avokatit të Popullit, e megjithatë ky organ ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese austriake për kushtetutshmërinë e një ligji të aprovuar.

Ligji i Bosnjë-Hercegovinës thotë : “Institucioni do të marrë në shqyrtim çështjet që përfshijnë funksionimin e dobët ose shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të kryera nga çdo organ qeveritar”. Edhe ombudsmani i Bosnjë-Hercegovinës mund të iniciojë procedime gjyqësore. Sipas ligjit portugez, funksioni kryesor i ombudsmanit është të mbrojë dhe të promovojë të drejtat, liritë, garancitë e interesat legjitime të qytetarëve duke e siguruar këtë nëpërmjet ndërhyrjes me mjete informale të ligjshmërisë dhe barazisë së ushtrimit të pushteteve publike.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.211, datë 30.1.2004

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV MAGIC
CHANNEL”**
SUBJEKTIT: Z. SPIRO ZGURI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin dhjetor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i jepë subjektit, z. Spiro Zguri me vendndodhje në Korçë, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.212, datë 30.1.2004

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO VENDOR PRIVAT “NACIONAL A.H.”
SUBJEKTIT: “RADIO NACIONAL A.H.” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, vendimin nr.204, datë 26.12.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “Radio Nacional A.H.” sh.p.k. me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonik tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 6.2.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë